

KONTRATE SHIT-BLERJE
TE KUOTAVE TE KAPITALIT

Sot me date 12.01.2001 (dymije e nje), dite e Premte, para meje Noteres TAMARA MALAJ, Notere ne Dhomen e Noterise Tirane, ne seli ne Rr. "L.Gurakuqi" P2, u paraqiten personalisht :-----

SHITESIT: Mirela TOPULLI e bija e Ridvan dhe Aferdita lindur ne TIRANE, me 28.09.1975, banuese ne Tirane Rr.e Dibres, Pall.5/3, Shk. 3,Ap.20" e paisur me Pasaporten nr.0062375.-----

Ridvan TOPULLI, I biri I Halit dhe Nishabure, lindur ne Gjirokaster, 05.01.1938, banues ne adresen e mesiperme, I pajisur me leternjoftimin AZ Nr.475508.

BLERESI: Gianfranco LIUZZI, i biri I Oronzo dhe Maria, i lindur ne Locorotondo (Bari), me 06.04.1947, i paisur me pasaporten italiane nr. 652377N, banues ne Tirane, Rruga "T.Tashko",Nr.7. ----

Te lart permendurit jane madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar te cilet deklaruan se lidhin Kontrate Shit-blerje te kuotave te kapitalit si vijon: -----

Shitesat Mirela e Ridvan TOPULLI, ne baze te kontratave te shitblerjes se kuotave te kapitalit, me aktin noterial me Nr.Rep.181 dhe Nr.Kol.16 date 07.08.1999 me Notere Elmira Kodra jane bere bashkpronar ne 60% te kuotes se kapitalit me Sh.p.k. "TEKNOMEDIA LTD", pra Ortake me zotin Gianfranco LIUZZI. Kjo Shoqeri eshte e regjistruar si person juridik me vendimin nr.16305 date 14.11.1996 te Gjykates se Rrethit Tirane. Sipas ketij akti Z.Gianfranco LIUZZI ka 40% te kuotave te kapitalit, Zonja Mirela TOPULLI 40% dhe Z.Ridvan TOPULLI 20% te kapitalit te kesaj Sh.p.k. Vec kesaj ma aktin noterial me Nr.Rep1269 dhe Nr.Kol.113 date 28.02.2000 me Notere Manushaqe Sharka Z.Gianfranco LIUZZI I ka shitur Mirela TOPULLIT dhe 40% te kuotes se kapitalit. Me vullnetin e tyre te lire e te plote shitesat deklarojne se kuoten e tyre te kapitalit te kesaj shoqerie te perbere ne masen 80% nga MIRELA dhe 20% nga RIDVAN TOPULLI, ja shesin plotesisht Z. GIANFRANCO LIUZZI me vleren e tij 100.000 leke (njeqind mije), shume e cila eshte likujduar plotesisht jashte kesaj zyre. Bleresi deklaroi se pranon te bleje kete kuote te kapitalit me cmimin qe ato kane caktuar ne marreveshje te perbashket. Me hartimin e kesaj kontrate pala shiteset e humbet te drejten e pronesise ne SHPK-ne e mesiperme, pra te ortakerise dhe pas paraqitjes ne Gjykate, te ketij akti pronare I vetem I kesaj shoqerie ne kuoten 100% te kapitalit behet bleresi GIANFRANCO LIUZZI.-----

Per te vertetuar sa me siper, u hartua prej meje Noteres kjo kontrate Shit-Blereje e kuotave te kapitalit, e cila pasi u lexua dhe u gjet sipas vullnetit te paleve,u nenshkrua prej tyre ne pranine time sipas ligjit,dhe une Noterja e vertetoj ate rregullisht.-----

Tirane, me dt 12.01.2001

SHITESIT

MIRELA TOPULLI

Mirela Topulli
Mirela Topulli


RIDVAN TOPULLI

(Ridvan Topulli)
[Signature]

BLERESI

GIANFRANCO LIUZZI

Gianfranco Liuzzi
[Signature]



TAMARA MALAJ
Rr. L. GURAKUQI, P.E. AP. 21
TIRANE
TEL. 298 32